FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 52	2002	Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 392, datë 15.8.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Elbasan në qarkun e Elbasanit ……	1497
Vendim i KM nr. 393, datë 15.8.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-kthesa Vau i Dejës (pjesë e segmentit rrugor Lezhë-Shkodër)…….	1502
Vendim i KM nr.394, datë 15.8.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Pogradecit ……	1506
Vendim i KM nr.395, datë 15.8.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Beratit ……..	1507

- Shpallje kërkesë për shpronësim për ndërtimin e segmentit rrugor Elbasan-Librazhd, pjesë e korridorit Lindje-Perëndim…… 1508

- Shpallje kërkese për shpronësim për ndërtimin e superstradës Vorë-Durrës, seksioni i parë Vorë-Sukth (Inter Change Sukth)…… 1522

- Shpallje kërkese për shpronësim për ndërtimin e segmentit rrugor Qukës-Qafë Thanë, pjesë e korridorit Lindje-Perëndim…… 1525

- Shpallje kërkese për shpronësim për ndërtimin e nënstacionit 400/110 kv Zemblak, Korçë…… 1529

- Shpallje kërkese për shpronësim për ndërtimin e kryqëzimit të Urës së Dajlanit, pjesë e superstradës Vorë-Durrës, seksioni i dytë Durrës-Sukth…… 1530

- Shpallje kërkese për shpronësim për ndërtimin “Depo uji të pijshëm” në qytetin e Gramshit…….. 1531

V E N D I M
Nr. 392, datë 15.8.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN NË QARKUN E ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Elbasan në Qarkun e Elbasanit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme të cilët shpronësohen të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 14 604 m2 tokë arë, 4 objekte të ndryshme me sipërfaqe 248 m2, 56 m/l mure rrethuese, një pus uji, 90 m2 servis mekanik, 54.2 m2 magazinë bujqësore, 36 m2 godinë në ndërtim, 189.73 m2 objekt klinik dhe banesë 3 katëshe+nënçati, 1 118 rrënjë drurë frutorë dhe 728 m2 rozmarinë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 49 426 358 (dyzet e nëntë milionë e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale është në shumën 815 000 (tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

5. Fondi prej 50 241 358 (pesëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.8.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 393, datë 15.8.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR-KTHESA VAU I DEJËS (PJESË E SEGMENTIT RRUGOR LEZHË-SHKODËR)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 pika 1 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër-kthesa Vau i Dejës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtj vendimi, për sipërfaqe 30801 m2 tokë/arë, truall 901 m2, 1 pikë karburanti me vlerë 16 772 609 lekë, 343 748 lekë kulturë bujqësore, 358 700 lekë drurë frutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 47 525 411 (dyzet e shtatë milionë e pesëqind e njëzet e pesë mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale është në shumën 498 000 lekë.

5. Fondi prej 48 023 411 (dyzet e tetë milionë e njëzet e tre mijë e katërqind e njëmbëdhjetë) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga Buxheti i Shtetit për vitin 2002, në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.8.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.394, datë 15.8.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E POGRADECIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20, dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të nenit 29 pika 1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve të cilët preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Pogradecit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Pogradecit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 5855 m2 tokë/arë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 5 855 000 (pesë milionë e tetëqindepesëdhjetëe pesë mijë) lekësh.

4. Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, zëri "Investime", t'i shtohet fondi prej 5 855 000 lekësh, i cili i pakësohet buxhetit të vitit 2002, zëri "Investime", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 163 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Bashkinë e Pogradecit, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 15-20 shtator 2002.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Financave, Prefektura e Qarkut të Korçës dhe Bashkia e Pogradecit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M
Nr. 395, datë 15.8.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të nenit 29 pika 1, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Beratit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Beratit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 5 000 m2 truall, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 10 660 000 (dhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.

4. Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, zëri "Investime", t'i shtohet fondi prej 10 660 000 lekësh, i cili i pakësohet buxhetit të vitit 2002, zëri "Investime", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 112 000 (njëqind e dymbëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Bashkinë e Beratit, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 15-20 shtator 2002.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Financave, Prefektura e Qarkut të Beratit dhe Bashkia e Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA EMËRORE E PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E BERATIT

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtim të objektit: segmenti rrugor Elbasan-Librazhd, pjesë e korridorit Lindje-Perëndim, në Qarkun e Elbasanit.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtim të objektit: “Superstradës Vorë-Durrës, seksioni i parë Vorë-Sukth (Inter-Change Sukth)”.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtimin e objektit: segmenti rrugor Qukës-Qafë Thanë, pjesë e korridorit Lindje – Perëndim, në rrethin e Librazhdit.

Me anë të këtij publikimi për shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që kanë pasuri pronë private të tipit tokë bujqësore dhe që preken nga shpronësimi me interes publik për ndërtimin e nënstacionit 400/110 KV Zemblak Korçë. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që do të shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës për çdo pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive të paluajtshme për ndërtim të objektit: "Kryqëzimit të Urës së Dalanit, pjesë e superstradës Vorë-Durrës, Seksioni i dytë Sukth-Durrës".

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit shpall kërkesën për shpronësim publik të objektit: "Ndërtim depo uji të pijshëm, me kapacitet 2000 m3 në qytetin e Gramshit".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Gramsh. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personin që preket nga ky shpronësim z.Dylber Ali Mema. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për sipërfaqen 2.255 m2 me çmimin 1210 lekë/m2 dhe vlerë totale 2.728.550 lekë.

Brenda 15 ditëve nga data e publikimit z.Dylber Ali Mema ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Transport-Telekomunikacionit.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 28. 8. 2002
Doli nga shtypi më 30. 8. 2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë